



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njesia Org. Org. Jedinica Org Unit	02
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	05-1219
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	- 3 -
Data: Datum: Date:	15, 03, 20 19
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria- Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Sekretari i Përgjithshëm - Generalni Sekretar - General Secretary

Nr.83.III.2019

Data:13.03.2019

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, duke marrë parasysh nenin 38 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2010), duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), si dhe në pajtim me nenin 5 (paragrafi 5.4. c) të Rregullores 2001/19 për Degën e Ekzekutivit, bazuar në nenin 12, 13 të Rregullores MF-NR-04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nxjerr:

V E N D I M

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projekte/programme të organizatave jo-qeveritare në fushën e Shëndetësisë” Ruajtja dhe përparimi i shëndetit.

I

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë, kodi ekonomik 90300, në kuadër të programit/nënprogramit 90301.

II

1. Mjetet e përmendura në nenin I do të shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II. të këtij vendimi përshinë:
 - 1.1. Teksti i thirrjes publike;
 - 1.2. Udhëzimet për aplikantët;
 - 1.3. Formularët e aplikimit ;
 - 1.4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve;
 - 1.5. Format për raportimin e zbatimit të projektit;
2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:

- 2.1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit;
 - 2.2. Forma e buxhetit të programit apo projektit;
 - 2.3. Forma e deklaramit të mungesës së fondeve të dyfishta;
 - 2.4. Deklaratat e Partneritetit (nëse është e aplikueshme);
 - 2.5. Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike;
 - 2.6. Deklarata për Aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatim (nëse aplikohet);
3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:
- 3.1. Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit;
 - 3.2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin;
 - 3.3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit;

IV.

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare <https://msh.rks-gov.net>.

V.

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

VI.

1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.
2. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Departamenti i Zhvillimit Shëndetësor.

VII

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit.

- Kabinetit të Ministrisë;
- Departamenti Ligjor;
- Arkivit të MSh.

Dr.Naim Bardhi

Sekretar i Përgjithshëm

